

V E N D I M
Nr. 600, datë 2.11.2001

PËR MËNYRËN E SHITJES SË MALLRAVE TË ARDHURA GRANT NGA QEVERIA E JAPONISË NË KUADËR TË PROJEKTIT II "RRITJA E PRODHIMIT USHQIMOR", 2 KR DHE PËR MIRATIMIN E FONDEVE BUXHETORE PËR REALIZIMIN E KËTIJ PROJEKTI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit" të ndryshuar, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shitja e mallrave të ardhura grant nga Qeveria Japoneze edhe për Projektin II, 2 KR, 2001 të bëhet sipas mënyrës së përcaktuar me vendimin nr.148, datë 31.3.2000, të Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e shitjes së mallrave të ardhura grant nga Japonia, në kuadër të projektit, "Shtimi i prodhimeve ushqimore" 2KR dhe të akteve të tjera të nxjerra në zbatim të këtij vendimi.

2. Për realizimin e fondit kundërparti të projektit të parë 2 KR 1999 për zbatimin e projektit 2 KR 2000 dhe të projektit "Non Projec Grant Aid" 1999-2000, për vitin 2001 miratohen:

a) 95 000 000 (nëntëdhjetë e pesë milionë) lekë, shpenzime për TVSH-në dhe taksën doganore.

b) 51 000 000 (pesëdhjetë e një milionë) lekë, shpenzime për koston lokale, nga të cilat:

30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, ndërsa pjesa tjetër të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2001 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit "Rritja e prodhimit ushqimor" 2 KR për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta